PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISË
BYROJA POLITIKE E KOMITETIT QENDROR

TEPËR SEKRET

Nr. 000036

PLATFORMA
E
PUNËS OPERATIVE
E ORGANEVE TË PUNËVE
TË BRENDSHME

Tiranë, 1985

PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISË
BYROJA POLITIKE E KOMITETIT QENDROR

TEPËR SEKRET

Nr. 000036

PLATFORMA
E
PUNËS OPERATIVE
E ORGANEVE TË PUNËVE TË BRENDSHME

(Miratuar në mbledhjen e Byrosë Politike
të Komitetit Qendror të PPSH datë 12.2.1985)

Tiranë, 1985

I

Organet e punëve të brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë janë një armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit, një repart politik dhe ushtarak i saj që udhëhiqen nga Partia e Punës e Shqipërisë për të zbuluar dhe shpartalluar veprimtarinë armiqsore dhe keqbërëse të armiqve të brendshëm e të jashtëm, për të mbrojtur fitoret e revolucionit e atdheun socialist, për të garantuar triumfin e çështjes së komunizmit.

Organet e punëve të brendshme kanë detyra themelore: mbrojtjen dhe sigurimin e paprekshmërisë së kufijve të atdheut; sigurimin e jetës të udhëheqësve të Partisë e të shtetit; zbulimin, parandalimin, dokumentimin e goditjen në kohë të veprimtarisë armiqsore e keqbërëse; ruajtjen e Forcave të Armatosura nga veprimtaria armiqsore e keqbërëse; mbrojtjen e ekonomisë socialiste nga çdo veprimtari armiqsore e keqbërëse; sigurimin e rendit e të qetësisë, mbrojtjen e jetës e të interesave të qytetarëve.

Në tërë veprimtarinë e tyre organet e punëve të brendshme udhëhiqen nga politika dhe ideologjia e Partisë së Punës të Shqipërisë, bazohen në Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe në ligjshmërinë socialiste, ato mbështeten fuqimisht te populli.

II

Udhëheqja e vazhdueshme e kontrolli i plotë, i gjithanshëm dhe i pandarë i Partisë në organet e punëve të brendshme realizohet nëpërmjet drejtimit drejtpërdrejt të organizatave-bazë, të komiteteve e byrove të Partisë në organe e reparte, të komiteteve të Partisë në rrethe, në reparte e njësi të ushtrisë dhe të Komitetit Qendror të Partisë.

Organizata-bazë, komiteti ose byroja e Partisë në organet e punëve të brendshme udhëheqin dhe kontrollojnë qëndrimin dhe veprimtarinë e gjithë komunistëve dhe punonjësve të këtyre organeve. Ato shqyrtojnë çdo problem të punës të sektorëve të ndryshëm; përcaktojnë detyra e masa për forcimin e punës dhe aktivizimin e komunistëve dhe të gjithë punonjësve. Në raste të domosdoshme ekspozimi i emrave të përpunimeve dhe të bashkëpunëtorëve në organizatën-bazë të Partisë bëhet kurdoherë me miratim të sekretarit

të komitetit ose të byrosë së Partisë të degës së punëve të brendshme.

Për sekretarin e komitetit ose të byrosë së Partisë të organit të punëve të brendshme nuk ka asnjë kufizim konspiracioni të punës operative.

Byrotë dhe komitetet e Partisë të rretheve analizojnë punën e organeve të punëve të brendshme dhe bëjnë vlerësimin e veprimtarisë së këtyre organeve lidhur me zbatimin e vijës e të direktivave të Partisë për zbulimin, parandalimin dhe goditjen në kohë të veprimtarisë armiqsore e keqbërëse në rreth, për sigurimin dhe ruajtjen e kufirit, për politikën e goditjes, për sjelljet e marrëdhëniet e punonjësve me popullin etj. Në këto analiza ruhet konspiracioni për çështjet e agjenturës, përpunimeve dhe formave e metodave të punës operative.

Për sekretarin e parë të komitetit të Partisë të rrethit nuk ka asnjë kufizim konspiracioni të punës operative të organeve të punëve të brendshme. Kryetari i degës të punëve të brendshme në rreth informon rregullisht sekretarin e parë të komitetit të Partisë të rrethit dhe, kur ky mungon për një kohë të gjatë, sekretarin që e zëvendëson, për të gjitha problemet që i dalin degës, qoftë për të orientuar punën e degës, ashtu dhe për të nxjerrë konkluzione e detyra për punën e Partisë në rreth.